



REPUBLIKA E KOSOVËS



KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË

Komiteti për Politikë dhe Financa

Nr. 02/ 357

Datë: 19.07.2023

Mbështetur në nenin 52 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, në bazë të nenit 27 të Statutit të Komunës së Malishevës, miratuar në mbledhjen e Kuvendit të Komunës së Malishevës me datë: 31.10.2008 (nr.01/871, datë:12.11.2008), nenin 20 pika b, të Rregullores nr.02/175 datë: 31.05.2017 për punën e Kuvendit, Komiteteve, dhe Komisioneve të Komunës së Malishevës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Malishevës me datë: 19.07.2023:

THËRRET

Mbledhjen e -VI- (gjashtë) të rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa për vitin 2023, e cila do të mbahet ditën e Premte me datë:21.07.2023 duke filluar nga ora :09:30.

Mbledhja do të mbahet në sallën e Komisioneve

Ftohet z/zj _____ që të marr pjesë në këtë mbledhje.

Për këtë mbledhje propozojë këtë:

RENDI I DITËS

- 1.Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e pestë e rregullt e mbajtur me datë: 23.05.2023 dhe mbledhjes së parë urgjente e mbajtur me datë:29.06.2023.
- 2.Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të të hyrave dhe shpenzimeve për periudhën janar-qeshor 2023.
- 3.Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/317 datë:22.06.2023, e parashtruar nga Kryetari i Komunës për dhënien në shfrytëzim të pronës shoqërore /komunale për realizimin e projekteve të KEDS për zgjerimin dhe përf forcimin e rrjetit të shpërndarjes dhe ndërtimin e trafostacioneve për regjionin e Komunës së Malishevës.
- 4.Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/960 datë:07.07.2023, e parashtruar nga Kryetari i Komunës për shpalljen zonë me interes të përgjithshëm publik për komunën e Malishevës dhe fillimin e procedurës për bartjen e pronës së pronës së menaxhuar nga Institucionet Qendrore-Agjensioni Kosovar i Privatizimit, në emër dhe pronësi publik të Komunës së Malishevës.
- 5.Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/271 datë:3.5.2023, e parashtruar nga Enver Mazreku për këmbim të pronës private me pronë publike.
6. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.04/382 datë:21.06.2023, për Ridestinimin e mjeteve për investime kapitale.
- 7.Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/940 datë:05.07.2023, e parashtruar nga Kryetari i Komunës për ndërrimin e pronës publike me pronë privat, për interes publik, me rastin e ndërtimit të infrastrukturës rrugore në qytezën e Malishevës.

8.Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të Auditimit për pasqyrtat financiare vjetore të Komunës së Malishevës për vitin 2022.

9.Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit gjashtëmujor i Drejtorisë për Bujqësi për vitin 2023.

10. Shqyrtimi i kërkesave.

11.Të ndryshme.

Malishevë, Korrik 2023

Kryesuesi i Këshillit

